KOORDINATORI PËR NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN PUBLIK

Andrea FIRANJ

– Koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik

– **Adresa postare:** Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë

– **Kodi postar**: 7005

– **Nr.tel** 08612 2 2026

– **Adresa elektronike**:andrea.firaj@bashkiamaliq.gov.al

Zyra e Bashkëqeverisjes dhe Performancës

Në zbatimin të nenit 10 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe ligjin nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" Autoriteti Publik cakton një prej nënpunësve si Koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e konsultimit me target grupet e ndryshme në komunitet.

Orari i administratës

E hënë – e premte, 08:^{00}-16:^{00}

Çfarë nënkupton konsultimi publik?

Konsultimi publik nënkupton marrjen e mendimeve dhe përfshijen e publikut për përmbajtjen dhe përmisimin e një akti ligjor, që është në hartim e sipër, (projekati), nga momenti i publikimit të projektaktit për mendim deri në miratimin përfundimtar të tij.

Kur dhe si zbatohet konsultimi publik?

Organet publike janë të detyruara të marrin masat e domosdoshme që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe palëve të interesuara në procesin e konsultimit publik. Për të realizuar këtë veprohet si më poshtë:

a) publikimi i projektaktit në regjistrin elektronik të institucionit (www.bashkiamaliq.gov.al) së bashku me të dhëna të lidhura me konsultimin e projektakteve;

b) publikimi i planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimarrjes (programi i transparencës);

c) dhënien e informacionit në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat.

Dhënia e informacionit në të gjitha fazat e konsultimit publik fillon nga publikimi i projektaktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve nga publiku, organizimi i debateve publike dhe së fundmi, miratimi i aktit përfundimtar.

Pas publikimit të njoftimit në regjistrin elektronik organi publik mund të organizojë edhe konsultime dhe takime publike me palët e interesuara, takime të cilat dokumentohen me procesverbal, si dokument zyrtar.

Çdo projektakt publikohet në regjistrin elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik.